



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.2 dhe nenit 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1 lidhur me nenin 10, paragrafi 2, pika 2.1, nenit 11 dhe nenit 16, të Ligjit Nr-04/L-174 për Planifikimin Hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimit për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Suharekës me Nr. 4444-2/21 i datës 21.01.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës-2022-230 me numër të protokollit Nr.4284-2/22 të datës 31.08.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e konform neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.10.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Suharekës-2022-2030 (HZK)

Neni 1

1.1 MIRATOHET- Vendimi për “Hartën Zonale për Komunën e Suharekës” për periudhën kohore 8, (tetë) vjeçare **2022-2030** (në tekstin e mëtejme HZK), si një dokument-multi-sektorial i cili përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe teksteve përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private.

1.2 “Hartën Zonale për Komunën e Suharekës” për periudhën **2022-2030** mbulon tërë territorin e Komunës së Suharekës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 361km² ose 36,099.00 ha si dhe është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal -2021-2029.

Neni 2

2.1 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Harta Zonale e Komunës së Suharekës-2022-2030” e hartuar nga Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim e Komunës së Suharekës, duke u bazuar në dispozita të Ligjit Nr-04/L-174 për planifikimin hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të Komunës, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe e miratuar me vendimin Nr. 4284-2/22 të datës 31.08.2022 për dhënien e pëlqimit për “Hartën Zonale të Komunës së Suharekës për periudhën kohore 2022-2030” nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

2.2 “Harta Zonale e Komunës së Suharekës për periudhën kohore 2022-2030” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Raportin e vlerësimit strategjik mjedisor, Planin e monitorimit dhe Raportin e shqyrtimit publik, në kopje fizike dhe digjitale dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi përkatësisht me miratimin e “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës për periudhën kohore 2022-2030”, “Harta Zonale e Komunës së Suharekës për periudhën kohore 2022-2030”, do të mbizotëroj ndaj çfarëdo Plani të mëhershme të Zhvillimit Urban ose Planit të mëhershëm Rregullues Urban.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-69078
Me datë 28.10.2022



Kryesuesi Kuvendit

Mirëc Bexhet KUÇI

